

Pasaporta vjeneze e arsimit

Pasaporta vjeneze e arsimit shërben si dëshmi për pjesëmarrjen tuaj në kurse të gjuhës, module të informimit, konsultime si edhe aktivitete të tjera të kualifikimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm.

Pasaporta vjeneze e arsimit përmban bono vjeneze për mësimin e gjuhës me një vlerë prej EURO 300,--, që mund të thyhen te çdo organizator i certifikuar kursesh.

Pasaportën vjeneze të arsimit mund ta paraqisni kudo ku pyeteni për njohuritë e gjuhës gjermane, kualifikimin profesional, përgatitjen dhe përgatitjen e mëtejshme.

Konkretisht tek:

- **organizatorët e kurseve të gjuhës gjermane**
- **aktivitetet e kualifikimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm**
- **konsultimet**
- **Shërbimi i Tregut të Punës**
- **punëdhënësit e mundshëm**

Partneret dhe partnerët e bashkëpunimit mund të shikojnë me një vështrim cilat masa keni shfrytëzuar dhe ç'farë hapash të tjerë kanë kuptim në rastin tuaj.

Prandaj është me rëndësi ta ruani mirë pasaportën vjeneze të arsimit dhe ta paraqisni gjithmonë kur shkoni tek institucionet e përmendura.

Në rastin e humbjes së pasaportës vjeneze të arsimit luteni të shkoni te shërbimi për sendet e gjetura dhe kërkoni një vërtetim mbi humbjen e pasaportës së arsimit.

Pas kësaj lidheni me centralin e telefonit nën numrin 01/90 500 36 – 01 (në gjuhën gjermane), 01/90 500 36 – 04 (në gjuhën angleze) ose 01/90 500 36 – 03 (në gjuhën boshnjake/serbe/kroate) dhe lini një takim me njërën prej trajnereve tona ose njërin prej trajnerëve tanë të startit. Në këtë takim do t'ju lëshohet pas paraqitjes së vërtetimit një pasaportë e re e arsimit.

Dosja e dokumenteve e pasaportës së arsimit

Gjatë trajnimit „Startcoaching” merrni bashkë me pasaportën tuaj të arsimit edhe një dosje dokumentesh.

Në këtë dosje mund t'i ruani të gjitha dokumentet, certifikatat, vërtetimet mbi pjesëmarrjen në kurset e ndryshme, fletët informative e konsultoreve të ndryshme etj.

Në momentin e dorëzimit dosja e dokumenteve përmban:

- **një parathënie**
- **deklaratën e firmosur nga ana juaj se jeni dakort me shfrytëzimin e të dhënave**
- **një përshkrim të partnereve dhe të partnerëve të bashkëpunimit për qëllimet e pasaportës së arsimit**
- **shpjegimin e pasaportës së arsimit, të bonove vjeneze për mësimin e gjuhës, të ofertës së moduleve**
- **takimet e para të rekomanduara**